



## **Qëndrim pa viza deri në më së shumti 90 ditë**

Kushtet për udhëtim pa vizë në Republikën Federale të Gjermanisë dhe shtetet e Schengen-it

Qytetarët e Maqedonisë mund të udhëtojnë pa vizë deri në më së shumti 90 ditë në një gjashtëmuor për qëllimet vijuese:

- Turizëm
- Udhëtim afarist
- Udhëtim për vizitë
- Udhëtime tjetra, të cilat **nuk** lidhen me krijimin e një marrëdhënie pune, për çka nevojitet leje e veçantë ( si p.sh.: kurse për mësimin e gjuhës, shkëmbim nxënësish, shkencëtarë të ftuar, shoferë kamioni dhe autobusi në kuadër të marrëveshjes CEMT, kualifikim i mëtejshëm etj.). Nëse synohet marrëdhënie pune atëherë propozohet të konsultohet ambasada lidhur me detyrimin eventual për paisjen me vizë.

**Udhëtimi pa viza vlen vetëm për personat që posedojnë pasaporta (të kuq) biometrik. Për pasaportat e deritashëm të kaltërt dhe qëllimet tjera të udhëtimit nevojitet vizë!**

Gjatë udhëtimit pa vizë, me kërkesën e shërbimeve kufitare, duhet të paraqiten dëshmi për financimin e qëndrimit dhe shpenzimet e udhëtimit si edhe dëshmi për qëllimin e udhëtimit.

### **Dëshmi mund të jenë p.sh.:**

lidhur me qëllimin e udhëtimit:

- turizëm: rezervime hoteli dhe udhëtimi
- udhëtime afariste: vërtetim i firmës në Gjermani, ftesë për konferenca, seminare ose takime etj.
- udhëtime për vizitë: ftesë nga miqtë / farefisi
- udhëtime tjera: vërtetim nga kursi për mësimin e gjuhës, shkolla ose organizata të ndryshme

lidhur me financimin:

- 1.) para në dorë, 45,-- € për çdo ditë qëndrimi  
**ose**  
çeqe udhëtimi  
**ose**  
fletëgarancion nga ftuesi

Fletëgarancinet sipas § 66 deri 68 të ligjit për qëndrim mund të merren nga ftuesi me vendbanim në Gjermani vetëm nga autoritetet gjermane për të huaj dhe gjatë hyrjes duhet të paraqiten në origjinal. Fletëgarancionet – si edhe deri tani në procedurën e vizava – janë të nevojshme atëherë kur udhëtari nuk posedon mjete të mjaftueshme personale (për shembull: 90 ditë qëndrimi, 45 euro për çdo ditë, do të thotë se në kufi mund të kërkohet dëshmi për 4.050 euro).

- 2) *Sigurim shëndetësor për udhëtim (mbulesë minimale 30.000.- euro, i vlefshëm për të gjitha shtetet e Shengen-it*
- 3) *eventualisht: biletë vajtje-ardhje (në kuadër të afatit 90-ditësh)*
- 4) *pasaportë e vlefshme biometrike, së paku tre muaj më shumë se qëndrimi i planifikuar*

Këto dëshmi duhet paraqitur gjatë hyrjes në territorin e shteteve të Schengen-it (d.m.th.në të astuquajturin kufirin e jashtëm të Schengen-it), nëse kërkohen nga shërbimet kufitare. Ju vemë në dijeni se një i huaj gjatë hyrjes në territorin Schengen-it mund të kthehet nëse nuk disponon me mjete të nevojshme financiare, respektivisht nuk mund në mënyrë legale të sigurojë mjetet e nevojshme financiare për qëndrimin ose kthimin në vendin e origjinës, respektivisht në vendin e tretë, për të cilin posedon leje qëndrimi. E njëjta vlen edhe atëhere kur ai nuk mund t'i parashtrijë dokumentat, të cilat e dëshmojnë qëllimin dhe rrethanat e qëndrimit të tij.

Vërejtje: vendimin për hyrje e marrin shërbimet e kontrollit kufitar. Jashtë informatave të përgjithshme, ambasada nuk mund të parashikojë se si do të zhvillohet kontrolli në kufi dhe çfarë vendimi do të merret në çdo rast individual.

Nëse ekziston ndalesë për hyrje ose qëndrim, hyrja edhe më tutje ndalohet.

**Numri i hyrjeve për një gjashtëmuajor, nëse qëndrimi i përgjithshëm prej 90 ditësh nuk tejkalohet, nuk është i kufizuar. Gjashtëmuajori fillon me hyrjen e parë. Pas një qëndrimi 90 ditësh në shtetet të Schengen-it, duhet të kalojnë 90 ditë për të hyrë përsëri „pa vizë“ në territorin e Schengen-it! Ky afat i pritjes nuk vlen nëse personi posedon vizë për ndonjë qëllim tjetër qëndrimi.**